



REPUBLIKA E SHQIPERISE
PRESIDENTI

DEKRET

PËR

**KTHIMIN E LIGJIT NR. 9235, DATË 08.06.2004
“PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONËS”**


Në mbështetje të neneve 93 dhe 85, pika 1, të Kushtetutës,

Dekretoj

Kthimin për rishqyrtim edhe një herë në Kuvend të ligjit nr. 9235, datë 08.06.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”.

Nr. Dekretit 4253
Tiranë, më 02.07.2004

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
ALFRED MOISIU**



17

**Motivimi i kthimit të Ligjit nr. 9235, datë 08.06.2004
“Për kthimin dhe kompensimin e pronës”**

Të nderuar deputetë,

Më datë 14.06.2004, nga Kuvendi më ka ardhur për shpallje Ligji nr. 9235, datë 08.06.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”.

Pasi e shqyrtova me vëmendje, mendoj se ligji i ardhur për dekretim ka nevojë të rishikohet në disa aspekte, me qëllim që të jetë sa më mirë i zbatueshëm dhe të evitojë mosmarrëveshje apo konflikte të panevojshme për shkak të mosrregullimeve të plota dhe interpretimeve të ndryshme që mund t’u jepen atyre.

Kështu, në nenin 16, pika 1/a dhe 3, është përcaktuar se Komiteti Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës ka të drejtë të shfuqizojë vendime të komisioneve vendore. Mendoj se kjo zgjidhje do ta implikonte në mënyrë të panevojshme procedurën dhe do ta zgjaste atë. Ankimi kundër vendimit të komisioneve vendore duhet të bëhet në gjykatë e eila duhet të mbesë autoriteti i vetëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të palëve në një konflikt. Situata do të komplikohet në mënyrë të panevojshme pasi nga kjo dispozitë nuk rezulton se cili do të jetë vendimi që ankimohet dhe se a mund të jenë të dy vendimet të ankimueshme, edhe ai i komisionit vendor edhe ai i Komitetit Shtetëror të Kthimit të Kompensimit të Pronës.

Një rregullim me implikime të panevojshme mendoj se është dhe e drejta e Komitetit Shtetëror, neni 16, pika 2, që të verifikojë vendimet e komisioneve që kanë zbatuar Ligjin nr. 7698, dt.15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, dhe Ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, dhe t’i shfuqizojë ato ose të kërkojë shfuqizimin e tyre në rrugë gjyqësore. Veç implikimeve me pasoja që mund të krijonte zbatimi i kësaj kompetence, ky rregullim jo vetëm që është i panevojshëm, por vjen në kundërshtim me parimet e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve mes palëve, ku një palë e tretë do të ndërhynte pa patur interesa të drejtpërdrejta në çështje. Kjo e drejtë e Komitetit Shtetëror mund të njihej në formën e mbrojtjes së interesave të shtetit atëherë kur, padrejtësisht, një pronë i është kthyer individëve, kur ajo nuk ka qenë e tyre, por e shtetit. Në të gjitha rastet e tjera, rregullimi i ofruar nga neni 16, pika 2, lë një hapësirë për rivlerësim

dhe njëherë të procedurave administrative dhe gjyqësore të ndërmarra që prej vitit 1991 e këtej në zbatim të ligjeve të miratuara nga Kuvendi.

Duke ia lënë një komiteti kompetencën të vlerësojë veprimtarinë e 13 viteve, të ndërmarra nga autoritete kompetente, komisionet e kthimit dhe kompensimit të pronave dhe gjykatat, mendoj se do t'i hapet rrugë një arbitrariteti, i cili mund të kishte pasoja më të rënda se sa zgjidhjet e deritanishme të paplota ligjore. Me këtë rast, mendoj se Avokatit të Shtetit mund t'i vihen detyra të posaçme që ai të ushtrojë funksionet e tij në mbrojtje të pasurisë shtetërore.

Gjithashtu, neni 15, krijon Komitetin Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës. Ky nen përcakton, kriteret dhe emërimin e anëtarëve të këtij komiteti, por as në këtë nen, as në ndonjë dispozitë tjetër të ligjit, qoftë dhe referuese, nuk përcaktohen rastet dhe mënyra e shkarkimit të anëtarëve të këtij komiteti. Një garanci e tillë mendoj se duhet të ishte parashikuar në ligj, pasi interpretimet e ligjit do të sillnin pështjellime të panevojshme politike. Po kështu, vlerësoj se nuk mund t'i mbeten interpretimeve të ligjit rastet e zëvendësimit të anëtarëve të këtij komiteti. Duhet të përcaktohen qartë rastet se cila do të jetë procedura dhe nga cila anë e spektrit politik do të jetë zëvendësuesi në rastin eventual të shkarkimit apo të largimit të një anëtari të komitetit.

Të nderuar deputetë,

Jam i ndërgjegjshëm për problematikën, dimensionin dhe rëndësinë që ka ky ligj. Ka qenë një proces i gjatë që prej vitit 1991 e në vazhdim që me nisma të ndryshme dhe institucionale është dashur të korrigjohet, për aq sa është e mundur, një gabim i sistemit të mëparshëm politik, e megjithatë, sërish zgjidhjet e ofruara nuk kanë qenë më të mirat. Për këtë shkak Kushtetuta e re, përcakton në nenin 181, detyrimin e rregullimeve sa më të drejta ligjore të çështjeve të konfiskimeve dhe kompensimeve, detyrë kjo që duhet të gjejë zgjidhjen sa më të mirë ligjore. Shqetësimi im në këtë drejtim është maksimal pasi vlerësoj se e drejta e pronës dhe e gëzimit të saj është një nga kollonat bazë të funksionimit normal të një shoqërie demokratike dhe se garantimi i saj do të konsolidonte zhvillimin e shoqërisë dhe shtetit shqiptar.

Konstatoj se ligji i miratuar nuk reflekton plotësisht pikën e parë të marrëveshjes së partive politike të 18 dhjetorit 2002, si dhe konstatoj

angazhime politike në një përqindje jo të vogël, të cilat janë kundër zgjidhjeve në aspekte të veçanta të ligjit. Ligji u inicua nga OSBE dhe u hartua me ndihmën e saj, por varianti i miratuar nuk respekton parime dhe elementë thelbësorë të marrëveshjes së arritur me ndërmjetësimin e OSBE-së. Gjithashtu një pjesë e forcave politike, të cilat drejtojnë një pjesë të konsiderueshme të bashkive, komunave, qarqeve dhe këshillave përkatës, kanë deklaruar mosnjohjen e ligjit dhe angazhimin politik për ta ndryshuar atë në rast ndryshimi në qeverisje, gjë që e cënon integritetin, besueshmërinë dhe hapësirën për veprim të proçesit të zbatimit të ligjit.

Për këto arsye, në ushtrim të kompetencave të mia kushtetuese dhe me përgjegjësinë për t'i kontribuar korigjimit pozitiv të proçesit të kthimit e kompesimit të pronave, vendosa të kthej ligjin për rishqyrtim në Kuvend.

Me këtë akt kushtetues u ofrohet një mundësi tjetër forcave politike parlamentare për të gjykuar me qetësinë dhe përgjegjësinë e duhur ligjin në fjalë, në mënyrë që ai njëherësh të korigjohet dhe të fitojë konsensusin e munguar. Ky duhet të jetë ligj i paqimit dhe jo i konfliktualitetit. Rëndësia e jashtëzakonshme e ligjit të kthimit dhe kompesimit të pronave shtron edhe njëherë nevojën që forcat politike të kërkojnë e të gjejnë konsensus maksimal për të gjitha çështjet madhore që kanë të bëjnë me të ardhmen e vendit dhe interesat madhore të tij. Kjo praktikë e munguar në vendin tonë, por e aplikuar me sukses në shumicën e vendeve të ish bllokut lindor, do të ishte një shërbim i çmuar për ecurinë e reformave demokratike, forcimin e shtetit ligjor dhe stabilitetit politik dhe për pasojë edhe për mbylljen me sukses të proçesit të integritetit euroatlantik të Shqipërisë.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
ALFRED MOISIU**

